

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Nr. 45 /2025
Dt. 12 / 02 /2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, në pajtim me nenin 11 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 22 (paragrafi 9) të Ligjit nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, në bazë të nenit 53 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores së QRK-Nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshim dhe plotësimin e Vendimit Nr.114/2024, të datës 10.05.2024

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1.1 e Vendimit Nr.114/2024, i datës 10.05.2024 për emërimin e anëtarëve të Panelit për Strehim Familjar, si në vijim:


“1.1.Blerim Shabani, Drejtor i Departamentit për Politikën e Shërbimeve Sociale dhe Familjare, Kryesues.”

2. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Vendimi i'u dërgohet:

- Z. Blerim Shabani;
- Anëtarëve të Panelit;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit për Politikën e Shërbimeve Sociale dhe Familjare;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 114 / 2024
Dt. 10 / 05 / 2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, të nenit 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 22 (paragrafi 9) të Ligjit nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores së QRK-nr.14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, si dhe në bazë të propozimeve të përfaqësuesve nga Asociacioni i Qendrave për Punë Sociale dhe propozimeve nga KOMF, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

- Emërohet Paneli për Strehim Familjar në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, me këtë përbërje:
 - Ruzhdi Osmani, Zëvendësues i Drejtorit të Departamentit të Politikave të Shërbimeve Sociale dhe Familjare, Kryesues;
 - Lutfi Bislimi, Zyrtar për Strehim Familjar dhe Kujdestari, anëtar;
 - Magbule Koci, Zyrtare e Lartë për Mbrojtjen e fëmijëve të braktisur, anëtar;
 - Adelina Rexhepi Braha, Drejtore e QPS-së Ferizaj, anëtare;
 - Ibadete Krasniqi, Drejtor Ekzekutiv në Organizatën për Fëmijët pa Kujdes Prindëror, anëtar.
- Mandati i anëtarëve të Panelit për Strehim Familjar zgjatë sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
- Obligohet Paneli që detyrat dhe përgjegjësitë tij t'i kryej në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
- Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Bazuar në ndryshimet ligjore me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare është ndyshuar edhe përbërja e Panelit për për Strehim Familjar konform nenit 22 (paragrafi 9) të këtij Ligji, me tre (3) anëtarë nga Departamenti përkatës dhe sipas propozimeve të pranuara nga një (1) përfaqësues i QPS dhe një (1) përfaqësues të OJQ, andaj është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi iu dërgohet:

- Kabinetit të Ministres së MD-së;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme të MD-së;
- Anëtarëve të Panelit për Strehim Familjar;
- DPSH SME/MD; dhe
- Arkivit të MD-së.